

**STATUT I SHOQËRISË  
NOA SH.A.**



**KAPITULLI I  
EMËRTIMI, FORMA LIGJORE- AKSIONERËT  
SELIA- KOHËZGJATJA - OBJEKTI**

**Neni 1  
Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është NOA Sh.a (më poshtë shoqëria ose NOA).

**Neni 2  
Forma Ligjore**

- 2.1 Shoqëria "NOA" Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar si shoqëri aksionare e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, këtë Statut dhe Aktin e Themelimit të saj.

**Neni 3  
Aksionerët e Shoqërisë**

- 3.1 Aksionerët e shoqërisë janë:
- NOA Holdings N.V., numri i aksioneve "73,182", përqindja në kapital "99.9986%", kontributi në para 731,828,781.84 Lekë (shtatëqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e katër lekë); dhe
  - NOA Coöperatief U.A., numri i aksioneve "1", përqindja në kapital "0.0014%", kontributi në para 10,000.12 Lekë (dhjetë mijë pikë dymbëdhjetë lekë).

**Neni 4  
Selia**

- 4.1 Selia e shoqërisë është në adresën Sheshi "Karl Topia, Kompleksi 127, Kulla 3, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci zyra përfaqësimi ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me veprimtarinë e saj.

**Neni 5  
Kohëzgjatja**

- 5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është 50 (pesëdhjetë) vjet, duke filluar që nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Shoqëria mund të përfundojë para afatit ose ta zgjasë

*Rich* 1  
*W cm*

këtë afat me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

## Neni 6 Objekti

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- i. të japë kredi;
- ii. të kryejë pagesa dhe arkëtime;
- iii. të emetojë, pranojë dhe administrojë instrumentat e pagesës;
- iv. të ofrojë shërbimin e këmbimit të monedhave;
- v. të ofrojë garanci të tjera (që nuk emërtohen garanci bankare);
- vi. të shërbejë si agjent financiar/rekuperues i kredive me probleme dhe konsulent (që nuk përfshihen në shërbimet e parashikuara në paragrafet 3(a) dhe 3(b) të Nenit 26 "Për Bankën e Shqipërisë");
- vii. të kryejë aktivitetin e qirasë financiare.

6.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

6.3 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

6.4 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjten veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj.

## KAPITULLI II KAPITALI - AKSIONET

### Neni 7 Kapitali i Shoqërisë dhe Kontributet

7.1 Kapitali aksioner i shoqërisë është 731,838,781.96 Lekë (shtatëqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një pikë nëtëdhjetë e gjashtë lekë).

7.2 Kapitali është i ndarë në 73,183 (shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) aksione që kanë një vlerë nominale prej 10,000.12 (dhjetë mijë/12) Lekë secili. Aksionet janë të pandashme.

7.3 Kapitali aksioner është nënshkruar dhe shlyer plotësisht prej aksionerëve:

- **NOA Holdings N.V.**, numri i aksioneve "73,182", përqindja në kapital "99.9986%", kontributi në para 731,828,781.84 Lekë (shtatëqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e katër lekë); dhe
- **NOA Coöperatief U.A.**, numri i aksioneve "1", përqindja në kapital "0.0014%", kontributi në para 10,000.12 Lekë (dhjetë mijë pikë dymbëdhjetë lekë).

*Rishi* 2  
*W* *CDM*

## Neni 8 Rritja e Kapitalit

- 8.1. Kapitali i shoqërisë zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, mbi bazën e raportit të Këshillit të Administrimit dhe/ose Administratorëve. Statuti i shoqërisë ndryshohet në përputhje me këtë rritje.
- 8.2. Kapitali mund të rritet në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose me kontribut në natyrë.
- 8.3. Aksionerët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve për rritjen e kapitalit. E drejta e përparësisë ushtrohet në raport me aksionet që zotëron aksionari në çastin e rritjes së kapitalit. Aksionerët mund të heqin dorë personalisht nga e drejta e nënshkrimit të aksioneve të reja.
- 8.4. Në rastin e rritjes së kapitalit me kontribute në natyrë, me vendim gjykate caktohet një ekspert në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 8.5. Rritja e kapitalit duhet të përfundojë brenda 5 (pesë) vjetëve nga data që Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve ka marrë një vendim të tillë.

## Neni 9 Zvogëlimi i Kapitalit

- 9.1. Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve në përputhje me mënyrën dhe kushtet e parashikuara në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 9.2. Këshilli i Administrimit dhe/ose Administratori/ët i dorëzon Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të mbledhur për marrjen e një Vendimi mbi zvogëlimin e kapitalit, një raport të arsyetuar i cili përshkruan rrethanat që kanë bërë të detyrueshme zvogëlimin e kapitalit.

## Neni 10 Shlyerja dhe Verifikimi i Kapitalit

- 10.1 Aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen përpara regjistrimit të tyre, të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale. Shumat që mbeten shlyhen në një ose më shumë këste, sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Aksionet e nënshkruara me kontribut në para që kanë çmim më të lartë se vlera e tyre nominale shlyhen plotësisht. Aksionet e nënshkruara me kontribut në natyrë duhet të shlyhen tërësisht përpara regjistrimit.
- 10.2 Në rast të rritjes së kapitalit, Këshilli i Administrimit duhet të verifikojë depozitimimin e kapitalit, në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që përcaktojnë kushtet mbi shlyerjen e kapitalit.

*Rien*

*W*

*qM*

## Neni 11 Aksionet

- 11.1. Aksionet janë të shprehura në vlerë nominale. Aksionet transferohen në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Në çastin e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj shoqëria mund të emërojë aksione me përparësi të cilat kanë avantazhe në raport me gjithë aksionet e tjera, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 11.2. Aksionet janë te pandashme. Ato kanë vetëm një primar kryesor. Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

## Neni 12 Transferimi i Aksioneve

- 12.1. Në rastin kur një aksioner dëshiron të transferojë të gjitha ose një pjesë të aksioneve të tij, është i detyruar të njoftojë me shkrim Këshillin e Administrimit, duke i bërë të ditur vlerën nominale të aksioneve me qëllim që aksionerët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Këshilli i Administrimit njofton me shkrim aksionerët e tjerë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për një transferim të tillë.
- 12.2. Aksionerët e tjerë duhet të njoftojnë Këshillin e Administrimit 3 (tre) muajve nëse ata do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo.
- 12.3. Në rast se numri i aksionarëve që dëshirojnë të blejnë aksione është më i madh se një, ata do të marrin aksione në përpjesëtim me numrin e aksioneve që zotërojnë.
- 12.4. Transferimi i aksioneve në ndryshim me sa është parashikuar në këtë nen do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të prodhojë efekte ligjore për shoqërinë.

## Neni 13 Të Drejtat dhe Detyrimet që lidhen me Aksionet

- 13.1 Çdo aksion i jep të drejtën zotëruesit të tij të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë në raport me aksionet që ai/ajo përfaqëson dhe në rast likuidimi të drejtën e pjesëmarrjes në asetet e mbetura të shoqërisë.
- 13.2 Aksionerët janë përgjegjës deri në vlerën e pashlyer të kontributit.
- 13.3 Te drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga aksionet ndjekin aksionet pavarësisht nga transferimi i tyre.

## KAPITULLI III ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 14 Organet e Shoqërisë

- 14.1 Shoqëria organizohet dhe funksionon nëpërmjet organeve të më poshtme:
- a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve;

*Rich*  
*W* *CPM*

b) Këshilli i Administrimit;

#### Neni 15

#### Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

- 15.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve është organi me i lartë i shoqërisë. Ajo vendos mbi çështjet e shoqërisë dhe vendimet e saj janë detyruese për shoqërinë.
- 15.2 Asambleja Përgjithshme e shoqërisë ka të gjitha kompetencat e parashikuara nga Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 15.3 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë për çështjet që vendosen me shumicë të zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionerët që zotërojnë 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur Asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse aksionerët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 15.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim ose janë përfaqësuar në votim (shumicë e kualifikuar), për vendime që lidhen me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për të gjitha çështjet e tjera të ndryshme nga sa u përmendën më lartë, Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shumicë të thjeshtë të votave të aksionarëve që marrin pjesë në votim ose janë përfaqësuar në votim.

#### Neni 16

#### Modalitetet e Thirrjes

- 16.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve thirret nga Administratorët, Anëtarët e Këshillit të Administrimit apo nga aksionerët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.2 Njoftimi i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerve bëhet në formë shkresore ose nëpërmjet korrespondencës elektronike. Ky njoftim i hartuar sipas parashikimeve ligjore së bashku me rendin e ditës i dërgohen të gjithë aksionerëve jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 16.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve si rregull mbahen në selinë e shoqërisë, por ato mund të mbahen edhe në çdo vend tjetër në territorin e Shqipërisë ose jashtë saj.

#### Neni 17

#### Vlefshmëria e Vendimeve

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve merr vendime të vlefshme edhe kur procedurat e thirrjes nuk janë respektuar, në qoftë se të gjithë aksionerët janë të pranishëm ose të përfaqësuar dhe bien dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 17.2 Një aksioner mund të përfaqësohet në bazë të një autorizimi nga një aksioner tjetër apo nga një person i tretë sipas mënyrës që parashikon Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 për

*Rich*  
*W* *Open*

“Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

### **Neni 18 E Drejta e Informacionit**

- 18.1 Administratorët janë të detyruar të vendosin në dispozicion të aksionerëve përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, të gjitha dokumentet që lidhen me çështjet e rendit të ditës.
- 18.2 Çdo aksioner ose përfaqësues i tij ka të drejtën të marrë informacion mbi çështjet e parashikuara në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në selinë e shoqërisë, duke filluar nga momenti i marrjes njoftim për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Në veçanti, ata kanë drejtën të marrin informacion për :
- regjistrat, bilancet, listat e Administratorëve dhe të anëtarëve të Këshillit të Administrimit,
  - raportet e Administratorit/ve, të Këshillit të Administrimit dhe Ekspertit Kontabël të autorizuar.
  - shumën e saktë të shpërblimeve të personave të mësipërm.
- 18.3 Çdo aksioner ka të drejtën të marrë informacion ose kopje të listës së aksionerëve dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit të paktën 21 (njëzetë e një) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

### **Neni 19 Përfaqësuesi i Aksionit**

- 19.1 Në rast se një aksioner zotërohet nga më shumë se një person, ata duhet të caktojnë një përfaqësues i cili ka të drejtën të ushtrojë të drejtat e aksionarëve.

### **Neni 20 Pjesëmarrës të Tjerë**

- 20.1 Anëtarët e Këshillit të Administrimit, Administratorët dhe Eksperti Kontabël mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve dhe të kenë vota konsultative. Nëse ata janë aksionarë, vota e tyre është vendosëse.

### **Neni 21 Lista e Aksionerëve**

- 21.1 Gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme përgatitet lista e aksionerëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.
- 21.2 Për mbledhjet mbahet procesverbal.

**Neni 22**  
**Kryetari i Asamblesë së Përgjithëshme**

- 22.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve zgjedh nga gjiri i vet një Kryetar që drejton mbledhien rast mbas rasti.

**Neni 23**  
**Këshilli i Administrimit**  
**(Sistemi me një nivel)**

- 23.1. Këshilli i Administrimit është organi që ushtron njëkohësisht funksione administrimi e mbikqyrje të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel).

**Neni 24**  
**Përbërja e Këshillit të Administrimit**

- 24.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga minimumi 3 (tre) deri në 7 (shtatë) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve. Anëtarët janë individë shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur në kuptim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë. Po kështu përveç parashikimeve dhe kufizimeve të ligjit, për të rritur pavarësinë e Këshillit të Administrimit të paktën 1/3 e anëtarëve të saj do të jenë individë të cilët gjatë zgjedhies dhe gjithë kohëzgjatjes së mandatit të tyre nuk duhet të kenë interesa private me shoqërinë apo aksionerët që ushtrojnë kontroll mbi shoqërinë apo administratorët.
- 24.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve cakton kryetarin e Këshillit të Administrimit dhe ky i fundit në mungesë të tij, cakton një zëvendës, që ngarkohen me mbledhien e këshillit dhe drejtimin e debatit gjatë mbledhies. Administratorët e shoqërisë nuk mund të caktohen në detyrën e kryetarit të Këshillit të Administrimit.
- 24.3 Anëtarët e Këshillit të Administrimit qëndrojnë në detyrë për një periudhë jo më shumë se 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhje.
- 24.4 Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit vendoset nga Asambleja e Përgjithshme.
- 24.5 Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të pezullohen ose shkarkohen në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

**Neni 25**  
**Kompetencat e Këshillit të Administrimit**

- 25.1 Brenda kompetencave dhe përgjegjësiive që i janë dhënë nga Ligji dhe nga ky Statut Këshilli i Administrimit në veçanti ushtron këtë veprimtari:
- a) Jep direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.
  - b) Kontrollon dhe mbikqyr zbatimin e politikave tregtare dhe performancën e shoqërisë në baza tre mujore dhe raporton tek aksionerët e shoqërisë;

7  
Ries  
W

- c) Kontrollon dhe mbikqyr librat kontabël, dokumentet dhe aktivitetet e tjera të shoqërisë;
- d) Raporton me shkrim tek Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të shoqërisë duke u shprehur nëse shoqëria vepron në përputhje me ligjin, aktet në fuqi të shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Aksionerëve, nëse pasqyrat dhe raportet vjetore financiare janë përgatitur në përputhje me të dhënat e shoqërisë dhe nëse ato paraqesin në mënyrë korrekte asetet dhe operacionet e shoqërisë, si dhe jep opinionin e vetë mbi propozimet e administratorëve mbi shpërndarjen e fitimit ose mbulimin e humbjeve të shoqërisë;
- e) Miraton buxhetin e shoqërisë përpara paraqitjes për miratim tek Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve;
- f) Emëron dhe shkarkon administratorët ose drejtuesit e lartë të shoqërisë që nuk janë administratorë dhe ndan kompetencat ndërmjet tyre.
- g) Përfaqëson shoqërinë tek menaxhimi i lartë drejtues dhe lidh kontratat respektive me ta.
- h) Mund të delegojë me shkrim përfaqësimin e shoqërisë dhe/ose kryerjen e veprimeve të caktuara të përfaqësimit tek një ose disa anëtarë të saj ose palë të treta.
- i) Përcakton një plan vjetor për shpërblimin (bonusin) e drejtuesve ekzekutiv dhe çdo plan shpërblimi (bonus) për punonjësit. Plani vjetor i shpërblimeve mirtohet në të njëjtën kohë me miratimin e buxhetit vjetor dhe do të miratohen në përfundim nga Asambleja e Aksionerëve.
- j) Propozon ekspertët kontabël të shoqërisë (audituesit e jashtëm);
- k) Ushtron çdo të drejtë dhe përgjegjësi tjetër të parashikuar nga ligji në fuqi për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

25.2 Këshilli i Administrimit jep miratimin me shkrim për kryerjen e veprimeve dhe operacioneve të mëposhtme:

- a) Përvetësimi, shitja, barrësimi, zhveshja nga pronësia e pasurive të paluajtshme, ose ushtrimi i çdo të drejte mbi pronësinë, ngritja e një pretendimi apo ndërmarrja e veprimeve tjera me efekte të ngjashme;
- b) Përvetësimi, shitja, barrësimi, zhveshja nga pronësia e aksioneve dhe garancive të dhëna nga shoqëri të tjera ndaj mbajtësit, ose respektivisht garancive që nuk janë përfshirë në kaptial, ose në borxh ose në tregun e parasë, kur këto veprime kryhen në emër të shoqërisë;
- c) Ndërmarrja ose vendosja e garancive, ndërmarrja e detyrimeve të ngjashme, ose hyrja në transaksione ligjore që mund të rezultojnë në detyrime të shoqërisë që tejkalojnë objektin e zakonshëm të veprimtarisë së shoqërisë;
- d) Sigurimi i huave ose kredive të tjera që tejkalojnë objektin e zakonshëm të veprimtarisë së shoqërisë dhe/ose të buxhetit të miratuar të shoqërisë, në veçanti sigurimi i huave ose kredive të drejtorëve dhe punonjësve të shoqërisë, bashkëshortëve të tyre, kushurinjëve, ose shoqërive në të cilat persona të tillë kanë interes të drejtë përdrejtë ose të tërthortë;
- e) Marrja përsipër e obligacioneve, detyrimeve nga huatë dhe kreditë që tejkalojnë 5% të aseteve të shoqërisë sipas pasqyrave të fundit financiare të çertifikuara;
- f) Investimet për aq kohë sa fondet e përfshira nuk parashikohen në buxhetin vjetor dhe tejkalojnë shumën 10,000 € (dhjetëmijë).

- g) Hyrja e shoqërisë në marrëveshje të cilat kanë afat ose sjellin efekte për një periudhë më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, ose prej të cilave rezultojnë detyrime ndaj shoqërisë që tejkalojnë shumën 100,000 Euro (njëqindmijë). Ky parashikim nuk është i aplikueshëm për marrëveshjet që përfshihen në objektin e zakonshëm të veprimtarisë së shoqërisë në kuadër të buxhetit të miratuar të saj;
- h) Ngritja dhe likuidimi i shoqërive të lidhura dhe zyrave të degëve si dhe kryerja e ndryshimeve në organizimin e brendshëm;
- i) Dhënia e shpërblimeve (bonuseve) në çdo rast ndaj drejtuesve dhe punonjësve të tjerë;
- j) Përvetësimi, shitja dhe barrësimi i interesit të zotëruar.
- k) Përfundimi i marrëveshjeve të transferimit të fitimeve ose humbjeve ndërmjet shoqërisë dhe kompanive të tjera;
- l) Të gjitha çështjet e tjera që tejkalojnë objektin e zakonshëm të veprimtarisë së shoqërisë;

#### Neni 26

#### Përgjegjësitë e Kryetarit, Zëvendës Kryetarit dhe Anëtarve

Për ushtrimin e kompetencave që i janë dhënë nga Ligji dhe ky Statut Kryetari, Zëvendës Kryetari dhe Anëtarët e tjerë të Këshillit kryejnë këto detyra kryesore:

- 26.1 Kryetari i Këshillit të Administrimit organizon dhe drejton aktivitetin e Këshillit dhe veçanërisht:
- Organizon mbledhjet e Këshillit të Administrimit;
  - Thërret dhe kryeson mbledhjet e Këshillit të Administrimit;
  - Sigurohet nëse është arritur kuorumi i kërkuar;
  - Propozon rendin e ditës së mbledhjeve;
  - Formulon propozimet për vendimet dhe organizon votimin sipas propozimeve;
  - Përcakton dhe shpall rezultatet e votimit mbi propozimet e posaçme;
  - Ekzekuton dhe delegon të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli i Administrimit.
- 26.2 Zëvendës Kryetari i Këshillit të Administrimit gëzon të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit dhe i ushtron ato në momentin kur Kryetari është në pamundësi të përmbushjes së funksioneve të tij.
- 26.3 Anëtarët e Këshillit të Administrimit në veçanti kryejnë aktivitetet e mëposhtme:
- Marrin pjesë në mbledhje;
  - Propozojnë thirrjen e mbledhjeve dhe në veçanti çështje të rendit të ditës;
  - Propozojnë ndryshime në rendin e ditës;
  - Propozojnë marrjen e vendimeve duke thirrur e zhvilluar mbledhjen me mjete elektronike dhe jo sipas rregullit të zakonshëm;

#### Neni 27

#### Mbledhjet

- 27.1 Këshilli i Administrimit mbledhet nga Kryetari ose në mungesë të tij nga zëvendësi i tij.

Riell  
W DM

- 27.2 Thirrja e mbledhjes kryhet nëpërmjet një njoftimi me shkrim të paktën shtatë ditë përpara nga data e planifikuar për zhvillimin e mbledhjes dhe në të duhet të përcaktohet vendi, ora e çështjet e rendit të ditës duke bashkëngjitur edhe materialet përkatëse për mbledhjen. Në rastet urgjente ose me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së Anëtarëve të Këshillit të Administrimit në mbledhje, ky afat mund të zvogëlohet ose ndryshojë.
- 27.3 Kryetari ose zëvendësi i tij do të përcaktojë rendin e ditës së mbledhjes duke patur në konsideratë kërkesat e paraqitura nga anëtarët e Këshillit të Administrimit.
- 27.4 Këshilli i Administrimit mblidhet minimumi katër herë në vit, ku të paktën për çdo tre muaj zhvillohet një mbledhje në përputhje me parashikimet e statutit dhe me nevojat tregtare e situatës në shoqëri. Në çdo rast, të gjithë anëtarët të Këshillit të Administrimit mund t'i kërkojnë kryetarit të mbledh menjëherë Këshillin duke paraqitur qëllimin dhe arsyet për mbledhjen. Mbledhja duhet të mbahet brenda një periudhe prej dy javësh nga data e thirrjes.
- 27.5 Në raste urgjente kur shtyrja e marrjes së vendimit mund të dëmtojë shoqërinë, kryetari mund të vendos që mbledhjet të konkludohen me conference call ose çdo mjet tjetër elektronik të përshtatshëm për zhvillimin e saj. Iniciativën për të kërkuar zhvillimin e mbledhjes në këtë mënyrë, e ka çdo anëtar dhe kërkesa duhet të jetë në formë të shkruar e t'i vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të tjerë të Këshillit të Administrimit. Nëse mbledhja do konkludohet me mjete elektronike, anëtarët do të paraqesin argumentat dhe votën e tyre tek kryetari nëpërmjet faksit, korrespondencës elektronike në mënyrë të tillë që të shprehin nëse votojnë "PRO" ose KUNDRA" vendimit të propozuar. Vendimi i miratuar nëpërmjet korrespondencës do të konfirmohet ose në mbledhjen vijuese të Këshillit të Administrimit, ose duke e qarkulluar tek secili anëtar i Këshillit të Administrimit.
- 27.6 Asambleja e Përgjithshme mund të caktojë individë nga brenda ose jashtë shoqërisë si për shembull, punonjës e specialist të aksionerit NOA Holding N.V, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Administrimit pa të drejtë vote me cilësinë e konsulentit ose vëzhguesit. Po kështu, Këshilli i Administrimit mund të ftojë në mbledhje pa të drejtë vote drejtues të lartë të shoqërisë që nuk janë anëtarë të Këshillit të Administrimit, konsulent, ekspert brenda ose jashtë shoqërisë të cilët mund të japin opinionet dhe konsulencën e tyre për çështje të caktuara apo ekspertët kontabël (audituesit e jashtëm) të shoqërisë lidhur me çështjet e auditimit dhe raportit të pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë.

## Neni 28 Procesverbali i Mbledhjes

- 28.1 Diskutimet e Këshillit të Administrimit do të mbahet me shkrim dhe do të nënshkruhet të gjithë anëtarët e pranishëm ose të përfaqësuar. Në procesverbal do të shënohet vendi, data e mbledhjes, personat e pranishëm, çështjet e rendit të ditës, pjesa thelbësore e debatit, atë çka është rënë dakort në mbledhje, vendimet e marra dhe rezultati i votimit.
- 28.2 Nëse një anëtar i Këshillit të Administrimit ka mendim ndryshe nga shumica që ka marrë vendimin, ai ka të drejtë të kërkojë që ky fakt të paraqitet në procesverbal.
- 28.3 Kërkesat me shkrim lidhur me çështjet e debatuar duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit.

- 28.4 Nëse mbledhjet zhvillohen me mjete elektronike dhe vendimet merren nëpërmjet korrespondencës, teksti i korrespondencës, së bashku me vendimin e anëtarëve do të trajtohen si procesverbal.
- 28.5 Procesverbali do të zbardhet brenda shtatë ditëve nga mbledhja. Procesverbali i mbledhjes së mëparshme do të verifikohet në mbledhjen vijuese.

#### Neni 29 Vendimet

- 29.1 Vendimet e Këshillit të Administrimit janë të vlefshme nëse në procesin e vendim marrjes janë të pranishëm ose të përfaqësuar më shumë se gjysma e anëtarve të saj, duke përfshirë kryetarin ose zëvendësin e tij. Anëtarët e Këshillit të Administrimit që mungojnë, mund të përfaqësohen nga çdo person i autorizuar prej tyre.
- 29.2 Këshilli i Administrimit merr vendime me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij të pranishëm ose përfaqësuar.
- 29.3 Kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit është përcaktuese. Abstenimet nuk do të llogariten si vota të dhëna.
- 29.4 Vendimet mbi rregulloret dhe procedurat organike të shoqërisë që lidhen me organizimin dhe drejtimin e saj, duhet të miratohen në mënyrë unanime nga Këshilli i Administrimit. Rregulloret do të nënshkruhet nga kryetari dhe secilit prej anëtarve do t'i vihet në dispozicion një kopje e Rregulloreve. Rregulloret do të hyjë në fuqi nga data e miratimit të tyre.

#### Neni 30 Konflikti i Interesit

- 30.1 Nëse Këshilli i Administrimit shqyrton një çështje që lidhet ose prek interesat personale, pasurore apo private të një anëtari të saj, atëhere ky anëtar nuk llogaritet në kuorum dhe përjashtohet nga votimi për këtë çështje.

#### Neni 31 Konfidencialiteti

- 31.1 Të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit pavarësisht nga data e mbarimit të mandatit të tyre, në mënyrë të përhershme duhet të ruajnë konfidencialitetin për çdo informacion që kanë përfituar gjatë mbledhjeve, informacion rreth shoqërisë dhe shoqërive të lidhura si dhe për vendimet e Këshillit të Administrimit, me përjashtim të informacionit që nuk konsiderohet konfidencial dhe që vlerësohet i njohur për palë të treta.
- 31.2 Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit do të shtrihet edhe tek personat e tjerë që marrin pjesë në veprimtarinë e Këshillit të Administrimit ose që në një mënyrë kanë përfituar informacion.

#### Neni 32 Administratorët

- 32.1 Veprimtaria dhe punët e përditshme të shoqërisë organizohen dhe drejtohen kryesisht nga Administratorët.
- 32.2 Shoqëria mund të ketë një ose më shumë Administratorë të cilët emërohen nga Këshilli i Administrimit me mandat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.
- 32.3 Në rastin kur shoqëria ka më shumë se një Administrator, atëhere ata do të organizohen sipas strukturës së mëposhtme, por pa u kufizuar:

- a) Drejtori i Përgjithshëm;  
b) Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm; si dhe  
c) Administratorë të tjerë

### Neni 33 Kompetencat e Administratorëve

33.1 Brenda kompetencave dhe përgjegjësiqe që i janë dhënë nga Ligji dhe nga ky Statut Administratorët kryejnë këto detyra:

- a) Marrin vendime për vënien në zbatim të politikave tregtare si dhe vendosin mbi të gjitha veprimtaritë e institucionit sipas objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të rastit kur këto veprimtari janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve ose të Këshillit të Administrimit.
- b) Raportojnë tek Këshilli i Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për aktivitetin e shoqërisë.
- c) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit në përputhje me ligjin për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe si dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloret përkatëse të miratuara nga Këshilli i Administrimit. Në çdo rast, Këshilli i Administrimit, gëzon të drejtën të vendosë mbi të gjitha çështjet ligjore në lidhje me marrëdhëniet ligjore ndërmjet Administratorëve dhe shoqërisë dhe marrëdhëniet ligjore që kanë të bëjnë me emërimin, largimin ose shkarkimin në çdo kohë të Administratorëve, kufizimin e kompetencave të tyre, shpërblimin e tyre etj.
- d) Në rast të transaksioneve që kërkojnë miratimin e Këshillit të Administrimit dhe ky i fundit nuk e jep atë, Administratoriët mund të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe ta paraqesin çështjen për shqyrtim.
- e) Përgatisin raportet dhe rendin e ditës së mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.
- f) Brenda 3 muajve nga dita e mbylljes së vitit financiar, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë të cilat së bashku me propozimet respektive ia paraqesin Këshillit të Administrimit për miratim, për tu paraqitur në vijim për miratim tek Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve.
- g) Kryejnë çdo vepir m tjetër të parashikuar në Ligj ose nga ky Statut.

### Neni 34 Përfaqësimi

34.1 Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtën dhe kompetencat të përfaqësojë dhe nënshkruajë në emër të shoqërisë, të delegojë të drejtat e tij si dhe të ushtrojë çdo të drejtë përfaqësimi për të gjithë veprimtarinë e shoqërisë, me përjashtim të transaksioneve, kontratave ,

marrëveshjeve dhe dokumentave të tjera të parashikuara në këtë statut për të cilat kërkohet miratim paraprak nga Këshilli i Administrimit. Në këtë rast, përfaqësimi nga Administratori i vetëm ose Drejtori i Përgjithshëm kryhet pasi është marrë më parë miratimi i Këshillit të Administrimit.

- 34.2 Administratorët e tjerë të shoqërisë të ndryshëm nga Drejtori i Përgjithshëm kanë të drejtë të përfaqësojnë dhe nënshkruajnë për llogari të shoqërisë ose të delegojnë këtë të drejtë tek persona të tretë mbasi kanë marrë miratim paraprak nga Drejtori i Përgjithshëm bazuar në Vendimin e Këshillit të Administrimit.

#### KAPITULLI IV KONTROLLI I SHOQERISË

##### Neni 35 Librat e Shoqërisë

- 35.1 Shoqëria duhet të mbajë librat e kërkuar nga ligji në të cilat regjistrohen llogaritë vjetore, deklaratat financiare vjetore, bilancet vjetore, raportet ekonomike vjetore.

##### Neni 36 Viti Financiar

- 36.1 Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë muajsh) duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron në 31 Dhjetor 2001.

##### Neni 37 Eksperti Kontabël

- 37.1 Asambleja e Përgjithshme emëron ekspertin kontabël i cili ka të drejtë të:
- Ndihmojë në mbajtjen e llogarive me qëllim që të jenë në përputhje me parimet kryesore të kontabilitetit.
  - Përgatis raportet vjetore me të dhëna ekonomike (bilancet, llogaritë e fitimit dhe të humbjeve dhe dokumente të tjera që lidhen me to) dhe japin mendimet e tyre nëse të dhënat ekonomike reflektojnë gjendjen ekonomike aktuale të shoqërisë.
  - Informon Këshillin e Administrimit mbi çdo parregullsi të mundshme të venë re nëpërmjet procedurave të tyre të zbatueshme, në veçanti sa i përket aseteve të shoqërisë që mund të kenë shkaktuar ose mund të shkaktojnë humbje për shoqërinë.

##### Neni 38 Kompetencat e Ekspertit Kontabël

- 38.1 Eksperti kontabël qëndron në detyrë për një afat të pacaktuar deri në shkarkimin e tij me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 38.2 Eksperti kontabël është i detyruar të mbikqyrë llogaritë vjetore dhe të auditojë nëse ato janë përpiluar në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin" dhe përmbajnë rezultatet e periudhës ushtrimore dhe jep rezultatin e plotë të vitit financiar që u mbyll. Eksperti

kontabël ka kompetencat që parashikohen në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**Neni 39**  
**Rezerva e Domosdoshme Ligjore**

- 39.1 Rezerva e domosdoshme ligjore krijohet nga të paktën 5 për qind e fitimit neto që mbetet pas zbritjes së humbjeve të viteve të kaluara. Një procedurë tillë nuk është e detyrueshme kur fondi rezervë bëhet sa 10 për qind e kapitalit aksioner.

**Neni 40**  
**Ndarja e Fitimeve**

- 40.1 Fitimi llogaritet si rezultat i fitimit të bilancit duke i zbritur rezervën ligjore të domosdoshme dhe humbjet e viteve të kaluara sipas nenit më sipër.

**Neni 41**  
**Dividentët**

- 41.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe llogaritjes së fitimit, Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën që do t'u jepet aksionarëve si dividend në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**KAPITULLI V**  
**PRISHJA**

**Neni 42**  
**Prishja**

- 42.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**Neni 43**  
**Likuidimi**

- 43.1 Shoqëria likuidohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.  
43.2 Shoqëria bën likuidimin në çastin e prishjes se saj për çfarëdolloj arsyeje me përjashtim të rastit të falimentimit.  
43.3 Gjatë likuidimit, emri i shoqërisë ndiqet nga shprehja "në likuidim". Ky emër si dhe emëri i likuidatorit duhet të pasqyrohen në të gjitha veprimet dhe dokumentet e lëshuara nga shoqëria tek të tretët.


## KAPITULLI VI

### Neni 44 Dispozita të Përgjithshme


- 44.1 Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- 44.2 Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.
- 44.3 Ky statut reflekton ndryshime të statutit të mëparshëm të shoqërisë dhe hyn në fuqi mbas regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## AKSIONARËT

NOA Holdings N.V., përfaqesuar nga:

  
ANDREAS THIELE

NOA Coöperatief U.A., përfaqesuar nga:

  
CLIVE MOSDY

  
GERA VOORRIPS

Përkthyes:

  
Felice Ferguson

**VENDIM 04 I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONAREVE TË SHOQËRISË  
"NOA" SH.A**

Sot më datën 12/11 2015, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "NOA" sh.a, regjistruar me Vendimin nr. 25341, dt 02.03.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr. Identifikimi (NIPT) K11604002V, me seli në adresën "Rr "Tish Daia", Kompleksi Haxhiu (Kika2), Pll. 2, K.1, Tiranë, Shqipëri "

Mbledhja u mbajt në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

Në mbledhje ishin të pranishëm aksionerët e mëposhtëm:

- 1. NOA Holdings N.V.**, një kompani publike me qendër ne Amsterdam, Hollandë, me adresë të regjistruar në Herengracht 500, 1017 CB Amsterdam, Hollandë, me numër regjistrimi 33268765 që zotëron 99.9986% të totalit të aksioneve, përfaqësuar ligjërisht nga **Z. Andreas Rolf Thiele**, shtetas Gjerman, lindur më 05/10/1967, identifikuar me pasaportë Nr. C5HT49WC1, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
- 2. NOA Cooperatief UA**, një shoqëri kooperative papërgjegjësi e krijuar sipas ligjit Hollandez me adresë të regjistruar në Herengracht 500, 1017 CB Amsterdam, Hollandë, me numër regjistrimi 34379979, që zotëron 0.0014% të totalit të aksioneve, përfaqësuar ligjërisht nga **Z. Clive David Moody** shtetas Britanik, lindur më 12/05/1963, identifikuar me pasaportë me Nr. 099064918, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

Asambleja e Përgjithshme u njoh me çështjet e rendit të ditës, si më poshtë:

**CËSHTJET E RENDIT TË DITËS**

Diskutimi dhe miratimi i ndryshimit të nenit 6.1 të statutit lidhur me shtimin ne objektin e veprimtarise se shoqerise

Diskutimi dhe miratimi i ndryshimit të nenit 16 dhe 17 të statutit lidhur me modalitet e thirrjes dhe zhvillimit të mbledhjes së Asmablesë si dhe me vlefshmërinë e vendimeve të Asamblesë së Aksionarëve.

Mbas diskutimit dhe shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë me unanimitet



## V E N D O S I:

Të miratojë ndryshimin e nenit 6.1 , 16 dhe 17 të statutit si më poshtë:

### 6.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- i. të japë kredi;
- ii. të kryejë pagesa dhe arkëtime;
- iii. të emetojë, pranojë dhe administrojë instrumentat e pagesës;
- iv. të ofrojë shërbimin e këmbimit të monedhave;
- v. të ofrojë garanci të tjera (që nuk emërtohen garanci bankare);
- vi. të shërbejë si agjent financiar/rekuperues i kredive me probleme dhe konsulent (që nuk përfshihen në shërbimet e parashikuara në paragrafet 3(a) dhe 3(b) të Nenit 26 "Për Bankën e Shqipërisë");
- vii. të kryejë aktivitetin e qirasë financiare.
- viii. të kryejë veprimtarinë e Agjentit në Sigurime

### Neni 16

#### Modalitetet e Thirrjes dhe Zhvillimi i Mbledhjeve të Asamblesë

- 16.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve thirret nga Administratorët, Anëtarët e Këshillit të Administrimit apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.2 Njoftimi i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve bëhet në formë shkresore ose nëpërmjet korrespondencës elektronike. Ky njoftim i hartuar sipas parashikimeve ligjore së bashku me rendin e ditës i dërgohen të gjithë aksionerëve jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 16.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve si rregull mbahen në selinë e shoqërisë, por ato mund të mbahen edhe në çdo vend tjetër në territorin e Shqipërisë ose jashtë saj. Aksionerët që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht në vendin e parashikuar për tu zhvilluar mbledhja kanë të drejtë:
  - të përfaqësohen në mbledhje në bazë të një autorizimi nga një aksioner tjetër apo nga një person i tretë sipas mënyrës që parashikon Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",
  - ose mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik që mundësojnë identifikimin e aksionerëve, krijojnë mundësinë që aksionerët të shprehet në kohë reale nga një vendodhje tjetër nga ajo e caktuar për mbajtjen e mbledhjes si dhe krijojnë mekanizma të përshtatshme votimi.

### Neni 17

#### Vlefshmëria e Vendimeve


- 17.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve merr vendime të vlefshme edhe kur procedurat e thirrjes nuk janë respektuar, në qoftë se të gjithë aksionerët janë të pranishëm ose të përfaqësuar dhe bien dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 17.2 Vendimet e miratuara nga Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë formalizohen në formë të shkruar. Në rastin kur Mbledhja e Asamblesë zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik vendimi i marrë formalizohet dhe konfirmohet në formë të shkruar në mbledhjen vijuese të Asamblesë, ose duke e qarkulluar atë tek secili aksioner.

Të autorizojë Zj. Polina Papagjoni dhe Z. Ermla Metaj që së bashku ose veç e veç të nënshkruajë aplikimin dhe të ndërmarrin të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e këtij vendimi në QKR.

### AKSIONERËT


1. "NOA Holdings N.V."

Përfaqësuar nga:

  
\_\_\_\_\_  
ANDREAS THIELE

2. "NOA Cooperatief U.A"

Përfaqësuar nga:

  
\_\_\_\_\_  
CLIVE MOOD

Përkthyes:  
Zj. Polina Papagjoni



**VENDIM 01 I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONAREVE TË SHOQËRISË  
"NOA" SH.A**

Sot më datën 24/04/2015 u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "NOA" sh.a, regjistruar me Vendimin nr.25341, dt 02.03.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr. Identifikimi (NIPT) K11604002V, me seli në adresën "Sheshi Karl Topia, Kompleksi 127, Kulla 3, Tiranë, Shqipëri "

Mbledhja u mbajt në përputhje me Statutin dhe Legjislacionin shqiptar.

Në mbledhje ishin të pranishëm aksionerët e mëposhtëm:

- 1. NOA Holdings N.V.**, një kompani publike me qendër ne Amsterdam, Hollandë, me adresë të regjistruar në Herengracht 500, 1017 CB Amsterdam, Hollandë, me numër regjistrimi 33268765 që zotëron 99.9986% të totalit të aksioneve, përfaqësuar ligjërisht nga **Z. Andreas Rolf Thiele**, shtetas Gjerman lindur më 05/10/1967 identifikuar me pasaportë Nr. 400981237, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
- 2. NOA Cooperatief UA**, një shoqëri kooperative papërgjegjësi e krijuar sipas ligjit Hollandez me qendër në Amsterdam, Hollandë dhe adresë të regjistruar në Herengracht 500, 1017 CB Amsterdam Hollandë, me numër regjistrimi 34379979, që zotëron 0.0014% të totalit të aksioneve, përfaqësuar ligjërisht nga **Z. Clive David Moody** shtetas Britanik, lindur më 12/05/1963, identifikuar me pasaportë me Nr. 099064918, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar dhe **Znj. Geertruida Cornelia Voorrips**, shtetase Holandeze lindur më 18/10/1965, identifikuar me pasaportë me Nr. NWD6JPFR0 dhe Nr. Personal 172989437, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**CËSHTJET E RENDIT TË DITËS**

Asambleja e Përgjithshme u njoh me çështjet e rendit të ditës, si më poshtë:

- Diskutimi dhe miratimi i ndryshimit të pikës 4.1 të statutit lidhur me adresën e selisë së shoqërisë.

Mbas diskutimit dhe shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë me unanimitet

**V E N D O S I:**

Të miratojë ndryshimin e pikës 4.1 të statutit lidhur me adresën e selisë së shoqërisë.

Pika 4.1 e statutit të shoqërisë është:

- Selia e Shoqërisë NOA Sha është "Sheshi Karl Topia, Kompleksi 127, Kulla 3, Tiranë, Shqipëri

 1

Pika 4.1 e statutit ndryshon si më poshtë:

- Selia e Shoqërisë NOA Sha është **Rruga "Tish Dahia", pranë Komunës së Parisit, Kompleksi "Haxhiu" (Kika 2), Pallati Nr. 2, Kati 1, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, Shqipëri**.


Ndryshimi i selisë së shoqërisë është i vlefshëm duke filluar nga data 27.04.2015

Të autorizojë juristen Zj. Polina Papagjoni të nënshkruajë aplikimin dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e këtij vendimi në QKR.

#### AKSIONERËT


1. "NOA Holdings N.V."

Përfaqësuar nga:

  
\_\_\_\_\_

2. "NOA Cooperatief U.A"

Përfaqësuar nga:

  
\_\_\_\_\_

CLIVE MOODY



G.C. Voorrips


Përkthyes:  
Zj. Polina Papagjoni



Nr. 4/15 Bregj.

Vertetohet se fotokopja  
është një me origjinalin.

Tirane, 07.04.2003



AKTI THEMELIMI I SHOQËRISE



"PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI" S.R.L.


Aksionerët e mëposhtëm kanë rënë dakord të themelojnë një shoqëri anonime në Shqipëri në përputhje me këtë Akti Themelimi dhe Statutin:

1. Mark Crawford lindur në Los Angeles, Kaliforni, më 11 korrik 1971, banues në Rruga "Islam Alla", Nr. 70, Tiranë, mbajtës i pasaportës nr. 082668088.
2. Roland Bagaviki lindur në Tiranë, më 18 mars 1973, banues në Rruga "Halim Xhelo", Nr. 12, Tiranë, mbajtës i pasaportës nr. 0382846.
3. Donika Kërçini lindur në Korçë, më 10 shtator 1957, banues në Rruga "Myslym Shyri", Blloku "50 Vjetori", Pallati 3/2/11, Tiranë, mbajtëse e pasaportës nr. 0463725.
4. Mishel Remarcka lindur në Tiranë, më 22 nëntor 1960, banues në Rruga "Luigi Gurakuqi", Pallati 15/1, Shkalla 7, Ap. 51, Tiranë, mbajtës i pasaportës nr. 296367.
5. Ariana Haxhiu lindur në Tiranë, më 8 qershor 1958, banuese në Rruga "Mujo Ulqinaku", Nr. 52, mbajtëse e pasaportës nr. 045641.
6. Kaila Musha lindur në Durrës, më 9 nëntor 1957, banuese në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati 51/1, Shkalla 1, Ap. 3, Tiranë, mbajtëse e pasaportës nr. 0650906.
7. John de Lanoy lindur në Santo Pipo, Argjentina, më 15 qershor 1936, banues në Lynettes, Crouch End, Coggeshall, Essex CO6 1UH, Angli, mbajtës i pasaportës nr. 500225374.
8. William Reichardt lindur në Chicago, Illinois, më 3 shtator 1937, banues në 1423, Monroe, River Forest, III 60305, USA.

#### Neni 1 Aksionerët Themelues

1.1 Aksionerët themelues të shoqërisë janë:


1. Mark Crawford
2. Roland Bagaviki
3. Donika Kercini
4. Mishel Remarcka
5. Ariana Haxhiu
6. Kaila Musha
7. John de Lanoy
8. William Reichardt



#### Neni 2 Forma Ligjore

2.1 Shoqëria krijohet në formën e shoqërisë anonime në bazë të ligjit Shqiptar "Për Shoqëritë Tregtare"

*Roland Bagaviki*  
*Roland Bagaviki*  
*Roland Bagaviki*



Neni 3

### Emri

3 | Emri i shoqërisë është "PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDIT" SHA.

Neni 4

### Selia

4 | Selia e shoqërisë është në adresën Rruga "Gjin Bue Shpatja", 7/1, Tiranë, ALBANIA.

4 | Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e vendit me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Neni 5

### Kohëzgjatja

5 | Kohëzgjatja e shoqërisë është 50 (pesëdhjetë) vjet, duke filluar që nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Shoqëria mund të përfundojë para këtij afati ose ta zgjasë këtë afat me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Aksionerëve, në përputhje me ligjin shqiptar.

Neni 6

### Objekti

6 | Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Të mbështesë financiarisht biznesin dhe biznesmenët shqiptarë.

6.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

6.3 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.

6.4 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj.


Neni 7

### Kontributet

7 | Në çastin e krijimit të shoqërisë, kapitali themeltar i shlyer në lekë është 2 000 000 (dy milion). Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht prej aksionerëve:

1. Mark Crawford zotëron 15 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 300 000 (treqind mijë) lekë.
2. Roland Bagaviki zotëron 15 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 300 000 (treqind mijë) lekë.
3. Donika Kërçini zotëron 10 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 200 000 (dyqind mijë) lekë.

*Handwritten signatures:*  
Roland Bagaviki  
Roland Bagaviki  
Donika Kercini



- 4. Mishael Remarcka zotëron 10 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 200 000 (dyqind mijë) lekë.
- 5. Ariana Haxhiu zotëron 10 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 200 000 (dyqind mijë) lekë.
- 6. Kaila Musha zotëron 10 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 200 000 (dyqind mijë) lekë.
- 7. John de Lanoy zotëron 15 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 300 000 (treqind mijë) lekë.
- 8. William Reichardt zotëron 15 për qind të kapitalit aksioner që i korrespondon shumës prej 300 000 (treqind mijë) lekë.

**Neni 8 Kapitali Themeltar**

1.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 (dy milion) ALL. Kapitali është i ndarë në 200 aksione që kanë një vlerë nominale prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë secili. Aksionet janë të pandashme.

**Neni 9 Këshilli Mbikqyrës**

9.1 Këshilli Mbikqyrës është organi që drejton shoqërinë. Ai përbëhet nga 3 (tre) antarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve. Anetarët e Këshillit Mbikqyrës janë:

- 1. Roland Bagaviki (kryetar)
- 2. William Reichardt (antar)
- 3. Donika Kërçini (antar)

**Neni 10 Drejtoria**

10.1 Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë është z. Richard Halmekangas.


**Neni 11 Viti Financiar**

11.1 Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron më 31 Dhjetor 2001. Këshilli Mbikqyrës mbikqyr llogaritë vjetore që të jenë në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin" dhe harton raportin mbi administrimin.

**Neni 12 Rezerva e Domosdoshme Ligjore**

12.1 Rezerva e domosdoshme ligjore krijohet nga të paktën 5 për qind e fitimit neto që mbetet pas zbritjes së humjeve të viteve të kaluara. Një procedurë e tillë nuk është e detyrueshme kur fondi rezervë bëhet sa 1/10 e kapitalit aksioner.

*Handwritten signatures:*  
Roland Bagaviki  
Roland Bagaviki  
Roland Bagaviki



**Neni 13 Dividendi**

13.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe llogaritjen e shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën që do tu jepet aksionerëve si dividend në bazë të neneve 215, 216 të ligjit të shoqërive.

**Neni 14 Prishja**

14.1 Shoqëria priset nëse ka mbruar kohëzgjatja e saj ose në rast se ka shpallur falimentimin.

**Neni 15 Likuidimi**

15.1 Shoqëria likuidohet në përputhje me dispozitat ligjore për falimentimin.

15.2 Shoqëria bën likuidimin në çastin e prishjes së saj për çfarëdolloj arsyeje me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 10 të ligjit të shoqërive.

15.3 Gjatë likuidimit, emri i shoqërisë ndiqet nga shprehja “në likuidim”. Ky emër si dhe emri i likuidatorit duhet të pasqyrohen në të gjitha veprimet dhe dokumentet e lëshuara nga shoqëria tek të tretët.

**Neni 16 Dispozita të Përgjithshme**

16.1 Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Akt Themelimi zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi për Shoqëritë Anonime pa ofertë publike.

16.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe 4 (katër) në gjuhën angleze dhe pasi iu lexua aksionerëve u nënshkrua prej tyre.

**AKSIONERËT**

- |                   |                        |                      |                 |
|-------------------|------------------------|----------------------|-----------------|
| 1- Mark Crawford  | <i>Mark Crawford</i>   | 5- Roland Bagaviki   | <i>Roland B</i> |
| 2- Donika Kercini | <i>Donika Kercini</i>  | 6- Mishel Remarcka   |                 |
| 3- Ariana Haxhiu  | <i>Ariana Haxhiu</i>   | 7- Kaila Musha       |                 |
| 4- John de Lanoy  | <i>Roland Bagaviki</i> | 8- William Reichardt | <i>Roland D</i> |

*Roland Bagaviki*